

UDHËZIM
Nr. 19, datë 7.10.2021

PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT TË KONSOLIDUAR
KOMBËTAR TË FERMËS

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; dhe të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim përcakton rregullat e krijimit dhe të integritetit të të dhënave për fermën, Regjistri Kombëtar i Fermës, si bazë e integruar dhe e unifikuar e të dhënave të mbajtura nga Agjencitë e Ekstensionit Bujqësor në regjistrat rajonalë të fermës dhe të të dhënave të tjera të administruara nga institucionet shtetërore dhe aplikuesit; popullimit të të dhënave; lëshimin e kartës së fermerit; mënyrën e përdorimit dhe të aksesit, si dhe veprimtari të tjera administrative.

2. Të gjithë termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

3. Regjistri Kombëtar i Fermës ka si qëllim:

a) pasqyrimin dhe gjenerimin e të dhënave për fermat, për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) unifikimin e të dhënave dhe kompjuterizimin e tyre, duke integruar të dhëna nga sistemi RUDA, skema e naftës për bujqësinë, të dhënat nga administrata tatimore;

c) pajisja e fermerëve me kartë fermeri;

d) përditësimi dhe përmirësimi periodik i bazës së integruar të të dhënave në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

e) akses i fermerëve, duke filluar nga regjistrimi, pajisja me kartë fermeri dhe përditësimi i të dhënave;

f) përdorimi i bazës së të dhënave për qëllime statistikore dhe dhënies së mbështetjes shtetërore për fermerët;

g) kalimi i të dhënave për Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural.

4. Regjistri Kombëtar i Fermës do të përmbajë të dhëna detyruese që në krijimin e tij, që transferon nga regjistrat rajonalë, si vijon:

a) për pronarin e fermës: i. emër, atësi, mbiemër; datëlindje; adresa e vendbanimit, numri personal dhe numër telefoni ose adresë tjetër për komunikim; personi fizik: emër, atësi, mbiemër; datëlindje; adresa e vendbanimit, numri personal, NUIS, numër telefoni ose adresë tjetër për komunikim; emri i subjektit, forma e organizimit, selia dhe NUIS, dhe për përfaqësuesin ligjor: emër, atësi, mbiemër; datëlindje; numri personal, numër telefoni ose adresë tjetër për komunikim;

b) kodin e fermës, i cili siguron identifikimin unik të fermës dhe mundëson identifikim të vendndodhjes administrative;

c) vendndodhja e fermës;

d) statusi i fermës në kohë reale.

5. Regjistri Kombëtar i Fermës do të përditësohet me të dhëna shtesë që transferohen nga regjistrat rajonalë, sipas vetëdeklarimit të aplikuesit ose të administruara në rrugë zyrtare, si vijon:

a) sipërfaqja totale e tokës në fermë, sipërfaqet e secilës parcelë, si dhe lidhja juridike (pronësi, qira, huapërdorje ose një formë tjetër), vendndodhja me hartë kadastrale ose adresë ngastre;

b) vendndodhja e fermës;
c) aktivitetet e fermës me të dhëna përkatëse;
d) mekanika bujqësore me të dhëna mbi çdo mjet;
e) përfitimet nga çdo skemë kombëtare mbështetëse ose financime nëpërmjet institucioneve shtetërore;

f) masat administrative të ekzekutueshme;

g) dokumente mbështetës/provues.

6. Regjistrimi i fermës për herë të parë, pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bëhet me kërkesë dhe karta e fermerit lëshohet me plotësimin e të dhënave, sipas pikës 4 të udhëzimit. Përditësimi dhe popullimi i të dhënave bëhet me vetëdeklarim ose si veprimtari administrative.

7. Detyrat e Agjencive të Ekstensionit Bujqësor:

a) sigurimin e plotësimit të regjistrit rajonal me të dhëna të verifikuara dhe në kohë reale;

b) pranimi i aplikimeve nga fermerët dhe popullimi i të dhënave, sipas vetëdeklarimit të fermerit ose sipas informacioneve dhe dokumentacionit të administruar nga sistemet e tjera, si sistemi RUDA, Skemat Kombëtare të Mbështetjes, Skema e Mbështetjes së Naftës në Bujqësi, programi IPARD etj.;

c) lëshimi i kartës së fermerit;

d) popullimi dhe përditësimi i të dhënave;

e) kalimi i të dhënave në mënyrë periodike në Regjistrin Kombëtar të Fermës.

8. Detyrat e grupit të punës në ministri:

a) siguri i plotësimit dhe i përditësimit të Regjistrit Kombëtar të Fermës, sipas përcaktimeve të udhëzimit dhe të dhënave të regjistrit rajonal;

b) garantimi i përdorimit të të dhënave dhe kalimi i të dhënave për Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural dhe institucionet e tjera të varësisë;

c) komunikimi me administratën tatimore për shkëmbim të dhënash.

9. Metodologjia e mbledhjes së të dhënave dhe përditësimi i tyre do të miratohet me urdhër ministri dhe do të zbatohet në të gjithë territorin në mënyrë të unifikuar.

10. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, drejtoria e përgjithshme që ka në varësi AREB-et dhe grupet e punës.

11. Udhëzimi nr. 14, datë 20.10.2020, "Për krijimin dhe mbajtjen e Regjistrit Kombëtar të Fermës", shfuqizohet.

12. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Frida Krifca